



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1760/24 Datë: 28/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet në nivel institucional Kolegji Dardania në Prishtinë për periudhë një (1) vjeçare 1 tetor 2024 – 30 shtator 2025.
- II. Obligohet Kolegji Dardania që deri më 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Dardania në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditim në nivel institucional të këtij institucioni të arsimit të lartë.

Me qëllim të vlerësimit të këtij institucioni për riakreditim në nivel institucional, AKA ka organizuar më 21.06.2024 vizitën në Kolegjin Dardania në Prishtinë me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit: *Peter Parycek, Elene Jiblatze, dhe Horia Onita.*

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertë ndërkombëtar të akreditimit) ka hartuar raportin e vlerësimit me rekomandime, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit (*përditësuar me vendimin e KShC-së Ref.932/22*) ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë fushat e standardeve të akreditimit në nivel institucional Kolegji Dardania i përmbushë Plotësisht një (1), Substancialisht gjashtë (6), Pjesërisht tri (3) dhe nuk përmbushë një (1) fushë të standardeve .

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin për riakreditim të Kolegjit Dardania në Prishtinë, dhe duke u bazuar në raportin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin. Hapja e Konfliktit Administrativ nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Dardania në Prishtinë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija llazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

